*30.05.2024*

# AIDA
# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **01** | 26.01.2024 | Në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, kërkoj të informohem për sa më poshtë vijon:<br><br>Më datë 01 / 08 / 2023, Komiteti i Investimeve Strategjike ka shpallur investim strategjik projektin "The Cliffs" i cili<br><br>propozohet nga grupi i investitorëve të huaj Adriatic Resorts LLC, kompani e së drejtës amerikane me adresën zyrtare në | 30.01.2024 | Kush u tërhoq nga projekti i parë, pala shtet apo kompania private dhe pse?<br>Pyetja ezaurohet nga i gjthe informacioni qe eshte publikuar tek webi AIDA nepermjet vendimit respektiv te KIS, i cili mund te akesohet ne link si me poshte:<br><br>https://www.aida.gov.al/images/PDF/Vendimet-e-komitetit/VENDIM_I_KOMITETIT_TE_INVESTIMEVE_STRATEGJIKE_KIS_ANULIM_E_VENDIMIT.pdf<br><br>Vendimi i sipercituar parashikon shprehimisht se mes paleve nuk arrit asnje marreveshje.<br><br>A është në dijeni kompania me projektin e ri se ka një padi civile për pronën?<br><br>Lidhur me piken 2 ju informojme se nga | E plotë | Nuk ka |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigjja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Cheyenne, ËY, USA, ortake e vetme e Adriatic Resorts Holding UK Limited, shoqëri e së drejtës angleze, me numër<br><br>kompanie 14320966, me zyra qendrore në Londër, Angli, për t’u realizuar nëpërmjet subjektit Adriatic Resorts sh.a. NUIS<br><br>M22221001A, me ortak të vetëm Adriatic Resorts Holding UK Limited, përfituesit fundor të të cilit janë deklaruar nga subjekti sipas kuadrit ligjor në fuqi. Po në të njëjtën datë i ëhstë hequr statusi i investimit strategjik projektit “Tirana City Centre”.<br><br>1- Kush u tërhoq nga projekti i parë, pala shtet apo kompania private dhe pse?<br><br>2- A është në dijeni | | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane eshte njoftuar me deftese komunikimi me nr. Akti 6482, datë 1.10.2021 mbi nje proces gjyqësor me te paditur Keshillin e Ministrave dhe Ministrine e Turizmit dhe Mjedist me objekt detyrimin e pales se paditur te njohur pronar me sendin truall me siperfaqe 18 458 m2, në ZK 8340 Tirane, nr. Pasurie 8/76. Me date 15.03.2023. Gjykata ka dale me vendim date 15.03.2023 dhe ka pushuar çeshtjen, pasi pala paditese nuk eshte paraqitur ne proçes gjyqesor.<br><br>A e dëmton imazhin e shqipërisë ndryshimi projekteve dhe invesitorëve?<br>Kjo nuk eshte nje pyetje per AIDA. Megjithate, KIS dhe te gjitha insitucionet e perfshira ne vleresim dhe vendimmarrje, sipas ligjit te Investimeve Strategjike kane te drejten dhe detyrimin qe te trajtojne cdo projekt propozim qe vjen nga subjektet e interesuar qe ploteson kriteret sipas ligjit dhe te perzgjedhin projektin e mundshem per tu realizuar.<br><br>A e di Komiteti i Investimeve Strategjike se Kush janë pronarët realë, fundorë?<br><br>Legjislacioni ne fuqi, perkatesisht ligji nr 122/2020 “Per regjistrin e pronareve perfitues” percakton qartesisht detyrimin e subjekteve dhe strukturat kompetente te trajtimi dhe regjistrimit te tyre. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kompania me projektin e ri se ka një padi civile për pronën?<br><br>3- A e dëmton imazhin e shqipërisë ndryshimi projekteve dhe invesitorëve?<br><br>4- A e di Komiteti i Investimeve Strategjike se Kush janë pronarët realë, fundorë? | | | | |
| **2.** | 04.03.2024 | 1. Vendimet e KIS te miratuara nga data 1 janar 2023 deri me date 29 shkurt 2024.<br>2. A eshte prodhuar raport per monitorimin e ecurise se investimeve nga ana e investitoreve qe kane marre statusin statusin strategjik nder vite?<br>3. A jane konstatuar shkelje nga invesitoret qe kane marre statusin strategjik nder vite, sa i takon numrit te punesimit dhe vleres se investimit? Nese po cilat jane keto | | 1.Ne webin e AIDA, ne hapesiren e dedikuar per investimet strategjike, gjendet i gjithe informacioni i nevojshem i publikuar dhe perditesuar lidhur me kete pyetje. Ju sqarojme se vendimet e KIS marrin daten respektive ne te cilen eshte zhvilluar mbledhja e KIS. Per lehtesine tuaj, vendimet te cilat do duhet t'i referoheni jane:<br>• Vendim Nr. 11/10, datë 01. 02.2023<br>• Vendim Nr. 17/2, datë 01. 02.2023<br>• Vendim Nr. 29/4, datë 01. 02.2023<br>• Vendim Nr. 13/8, datë 01. 02.2023<br>• Vendim Nr. 20/15, datë 06.06. 2023<br>• Vendim Nr. 25/15, datë 06.06. 2023<br>• Vendim Nr. 23/4, datë 06.06. 2023<br>• Vendim Nr. 30/8, datë 06.06. 2023<br>• Vendim Nr. 34/11 datë 01.08. 2023<br>• Vendim Nr. 7/21, datë 01.08. 2023<br>• Vendim Nr. 16/11, datë 01.08. 2023<br>• Vendim Nr. 1/4, datë 01.08. 2023<br>• Vendim Nr. 10/8, datë 01.08. 2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | projekte?<br>4. A jane marre masa nga KIS per revokimin e statusit te investitorit strategjik? | | • Vendim Nr. 2/20, datë 01.08. 2023<br>• Vendim Nr. 6/16, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr. 11/5, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr.8/26, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr. 7/8, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr. 19/7, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr. 27/8, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr. 32/6, datë 30.10.2023<br>• Vendim Nr.12/5, datë 30.10.2023<br>2. AIDA cdo vit publikon Raportin Vjetor ku nje ze te rendesishem ze kapitulli i investimeve strategjike. Ne webin e AIDA ne link https://aida.gov.al/aida/raport-vjetor/ gjeni Raportet e viteve te kaluara ku perfshihet edhe pjesa e investimeve strategjike. Nderkohe brenda muajit mars ne te njejten rubrike do te gjeni te publikuar dhe Raportin Vjetor te vitit 2023. Per tju ardhur sa me shume ne ndihme, ne bashkelidhje gjeni edhe tabelen e perditesuar me te dhena.<br>Lutem te kihet parasysh qe referuar legjislacionit ne fuqi:<br>• Cdo miratim nga KIS ne asnje rast nuk do te konsiderohet investim, qofte sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij nderkombetar, ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, duke qene se miraton ne parim realizimin e nje projekti investimi, materializimi i te cilit do të bazohet ne permbushjen e detyrimeve dhe kushteve qe parashikojne legjislacionet sektoriale në fuqi.<br>• Per cdo projekt investimi per te cilat me vendim KIS eshte miratuar nje nga masat mbeshtetese qe parashikon legjislacioni ne fuqi, ekzekutimi i mases | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mbeshtetese realizohet vetem me vendim te Keshillit te Ministrave dhe nje kontrate te lidhur me autoritetin kompetent, sipas legjislacionit ne fuqi. Ne kete rast kontrata e lidhur i nenshtrohet monitorimit nga autoriteti kompetent sipas kushteve te miratuara ne VKM dhe dakordesuara mes paleve ne kontrate. Referuar te gjitha projekteve strategjike te miratuara ne KIS, ashtu si do e vini re dhe ne tabelen monitoruese, numri i atyre projekteve per te cilat eshte lidhur kontrate me autoritetin kompetent eshte 11 kontrata.<br>3. Ashtu sikurse shpjegohet ne pyetjen nr. 2 AIDA monitoron vetem planin e veprimit qe KIS miraton me vendim e qe duhet te ndjekin institucionet komptetente per te asistuar, mbeshtetur dhe/ose vene ne dispozicion masa mbeshtetese nepermjet nje vendimi te Keshilllit te Minsitrave dhe nje kontrate me autoritetin publik sipas legjislacionit ne fuqi. Autoriteti publik qe monitoron kontraten ka tagrin te konstatoje e te shprehet.<br>4. Ne reference te nenit 19 te ligjit te Nr. 55/2015 "Per investimet strategjike ne RSH" i ndryshuar parashikon se "Ne rast se pergjatë pergatitjeve, zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komiteti i Investimeve Strategjike konstaton dhe verteton se ne projektin investues ka te dhena te paverteta apo ndryshim te te dhënave te dala rishtazi, mbi bazen e te cilave nuk do te ishte vendosur per perfshirjen e ketij projekti ne proceduren e asistuar/e veçante, Komiteti i Investimeve Strategjike revokon vendimin per dhenien e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | statusit "Investim/investitor strategjik, procedure e asistuar/e veçante". Deri me tani prane Sekretariatit Teknik te KIS, AIDA, nuk ka asnje rast te referuar ku autoriteti publik pergjegjes per monitorimin e nje projekti investimi te jete ndodhur perballe kushteve te parashikuara e vertetuara ne kete dispozite. | | |
| **3.** | 19.03.2024 | Ju lutem te na vini ne dispozicion dy projekt propozimet per zhvillimin e resorteve turistike ne Sazan dhe Zvernec.<br><br>Kur eshte dorezuar projekt propozimi per zhvillimin turistik te ishullit te Sazanit dhe Zvernecit prane AIDA-s ( data dhe ora) ?<br><br>Sa kohe do te marre shqytrimi i ketij propozimi dhe kur pritet nje vendimmarrje nga AIDA per dy projektet? | 21.03.2024 | • Ju lutem te na vini ne dispozicion dy projekt propozimet per zhvillimin e resorteve turistike ne Sazan dhe Zvernec.<br><br>Prane Agjencise Shqiptare te Zhvillimit te Investimeve (AIDA) nuk eshte paraqitur asnje projekt investimi, por vetem nje shprehje interesi nga kompania Atlantic Incubator Partners LLC per realizimin e nje Resort Turistik ne ishullin e Sazanit. Aktualisht, projekti ne fjale eshte ne proces asistimi prane institucionit tone dhe jemi duke vleresuar te gjitha kriteret ligjore qe parashikon legjislacioni per investimet strategjike, perkatesisht, ligj Nr. 55/2015 i ndryshuar dhe VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Per vleresimin e dokumentacionit". Persa i takon projektit te Zvernecit, ju bejme me dije se prane AIDA nuk eshte paraqitur asnje shprehje interesi dhe as nje projekt propozimi.<br><br>• Kur eshte dorezuar projekt propozimi per zhvillimin turistik te ishullit te Sazanit dhe Zvernecit prane AIDA-s ( data dhe ora) ?<br><br>Ashtu sikurse ju sqaruam dhe ne pyetjen me lart, prane AIDA nuk eshte dorezuar asnje | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | projekt – propozim per projektin e ishullit te Sazanit, por vetem nje shprehje interesi dhe nje pjese e dokumentacionit. Dokumentacioni eshte ne proces vleresimi ne perputhje me kriteret e legjislacionit te investimeve strategjike.<br><br>• Sa kohe do te marre shqytrimi i ketij propozimi dhe kur pritet nje vendimmarrje nga AIDA per dy projektet?<br><br>AIDA është struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve për investitorin në një "dritare unike" për investitorët/projektet, të cilat aplikojnë dhe kërkojnë të përfitojnë statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".<br><br>Ne perputhje me parashikimet e ligjit nr. 55/2015, "Per investimet strategjike në RSH" i ndryshuar, çdo subjekt investues i interesuar, person juridik privat, vendas ose i huaj, ka te drejten per te kerkuar perfshirjen e nje projekti investues ne procedurat administrative te investimeve strategjike, me qellim marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedure e asistuar" apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçante". Subjektet e interesuara, te cilat kerkojnë perfshirjen e projekteve te tyre investuese ne procedurat administrative te investimeve strategjike, paraqesin, per kete qellim, nje kerkese me shkrim prane AIDA, se bashku me dokumentacionin perkates. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | AIDA ne rolin e agjentit asistues, ne zbatim te detyrave te percaktuara ne kete ligj, ndjek te gjitha procedurat administrative te parashikuara qe nga momenti i paraqitjes se kerkeses per perfshirjen ne procedurat administrative per përfitimin e statusit "Investim/investitor strategjik" deri në perfundimin e te gjitha procedurave administrative, te parashikuara nga ky ligj.<br><br>Per sa ti takon projektit te ishullit te Sazanit, ne momentin qe subjekti do te dorezoje prane AIDA te gjithe dokumentacionin e plote per aplikim, bazuar ne kriteret e parashikuara ne ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1026, date 16.12.2015 "Per vleresimin e dokumentacionit", AIDA do te verifikoje dokumentacionin e depozituar dhe do te kryeje vleresimin e projektit me potencial strategjik. Vleresimi i potencialit te projektit, nga AIDA, kryhet nepermjet Grupeve Operacionale, te posaçme per çdo projekt, te perbere nga eksperte te ministrive te linjes, te fushave ne te cilat kerkohet te realizohet investimi strategjik, brenda 30 diteve pune nga data e paraqitjes se plote te dosjes se projektit. Nese konstatohet se dokumentacioni eshte i paplote, i kerkohet, me shkrim, subjektit investues plotesimin e te gjitha dokumenteve dhe te dhenave te kerkuara. Subjekti investues duhet te plotesoje dokumentacionin brenda nje afati 10-ditor nga dita e marrjes se njoftimit.<br>Me pas dokumetancioni i plote paraqitet prane Komitetit te Investimeve Strategjike (KIS), i cili eshte dhe organi kolegjial vendimmarres per dhenien ose jo te statusit investim/investitor | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | strategjik. AIDA nuk ka tagra vendimmarres, por luan rolin e Sekretariatit Teknik te KIS. | | |
| **4.** | 20.03.2024 | A eshte bere ndonje kerkese, diskutim apo mareveshje konkrete lidhur me investimin ne Ishullin e Sazanit, i cili do te kryhet nepermjet kompanise [redacted] dhe me perfitues kryesor [redacted]<br>A posedoni dosje te perpilluar per kete, me te gjitha te dhenate ketij investimi? Nese po, ju lutem te na e vendosni ne dispozicion te gjithe informacionin lidhur me kete investim. | 21.03.2024 | Në vjiim të shkresës "Kërkesë për Informacion" protokolluar pranë AIDA me Nr. 461 Prot., datë 20.03.2024 ju informojmë si më poshtë vijon:<br>Pranë AIDA është paraqitur vetëm një shprehje interesi nga kompania "Atlantic Incubator Partners LLC" për realizimin e një Resort Turistik në ishullin e Sazanit.<br>Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në RSH" i ndryshuar, çdo subjekt investues i interesuar, person juridik privat, vendas ose i huaj, ka të drejtën për të kërkuar përfshirjen e një projekti investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".<br>Subjektet e interesuara, të cilat kërkojnë përfshirjen e projekteve të tyre investuese në procedurat administrative të investimeve strategjike, paraqesin, për këtë qëllim, një kërkesë me shkrim pranë AIDA, së bashku me dokumentacionin përkatës.<br>AIDA në rolin e agjentit asistues, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë ligj, ndjek të gjitha procedurat administrative të parashikuara që nga momenti i paraqitjes së kërkesës për përfshirjen në procedurat administrative për përfitimin e statusit "Investim/investitor strategjik" deri në perfundimin e të gjitha procedurave administrative, të parashikuara nga ky ligj.<br>Aktualisht, meqenese jemi ende në proces asistimi/vlerësimi paraprak, AIDA është duke | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | vleresuar të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit" dhe nuk ka ende një aplikim me dokumentacion të plotë për këtë projekt. | | |
| **5.** | 28.03.2024 | Kur eshte depozituar kerkesa per investim ne ishullin e Sazanit?<br>Vendosni ne dispozicion projektin e propozuar nga kompania?<br>Per cfare afati kohor kerkon investitori te shfrytezoje token?<br>Sa siperfaqje kerkohet te merret per investim? | 02.04.2024 | Kur eshte depozituar kerkesa per investim ne ishullin e Sazanit?<br>Prane AIDA eshte paraqitur nje shprehje interesi nga kompania Atlantic Incubator Partners LLC. Kjo kerkese ka ardhur me date 27.12.2023.<br><br>Vendosni ne dispozicion projektin e propozuar nga kompania? Per cfare afati kohor kerkon investitori te shfrytezoje token? Sa siperfaqje kerkohet te merret per investim?<br>Prane Agjencise Shqiptare te Zhvillimit te Investimeve (AIDA) nuk eshte paraqitur asnje projekt investimi, por vetem nje shprehje interesi nga kompania Atlantic Incubator Partners LLC per realizimin e nje Resort Turistik ne ishullin e Sazanit. Aktualisht, projekti ne fjale eshte ne proces asistimi prane institucionit tone dhe jemi duke vleresuar te gjitha kriteret ligjore qe parashikon legjislacioni per investimet strategjike, perkatesisht, ligj Nr. 55/2015 i ndryshuar dhe VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Per vleresimin e dokumentacionit". | E plotë | Nuk ka |
| **6.** | 24.04.2024 | 1. Per cilat zona ka shfaqur interes zyrtarisht dhëndri i ish-presidentit Trump, Jared Kushner për të investuar në | 25.04.2024 | Prane AIDA eshte paraqitur vetem nje shprehje interesi nga kompania Atlantic Incubator Partners LLC per ishullin e Sazanit. Projekti ne fjale eshte ne proces asistimi prane institucionit tone dhe jemi duke vleresuar te gjitha kriteret ligjore qe parashikon legjislacioni per investimet strategjike, perkatesisht, ligj Nr. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shqipëri?<br>2. Cili është subjekti ekonomik/kompania me të cilën përfaqësohen në Shqipëri? Lompania me të cilën ka depozituar kërkesën e shfaqjes së interesit?<br>3. A ka vijuar asistenca nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike për të plotësuar dokumentacionin për të aplikuar për statusin e investimit strategjik?<br>4. A ka deri më tani një aplikim me projekt për të marrë statusin e projektit të investimit strategjik dhe të operatorit ekoniomik si investitor strategjik? (I referohem rastit në fjalë)<br>5. Nëse ka, mund të na vendosni në dispozicion projektin pa informacionet të kategorizuara | | 55/2015 i ndryshuar dhe VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Per vleresimin e dokumentacionit”. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kofidenciale nga vet operatori? Sa është vlera që synohet të investohet? | | | | |
| **7.** | 22.05.2024 | Së shpejti në [redacted] do të trasmetohet një dokumentar me fokus turizmin. Për këtë çështje do të doja informacion nga institucioni juaj:<br>1. Në cilat zona bregdetare janë duke u zhvilluar projekte në fushën e ndërtimit?<br>2. Cili është raporti mes investitorëve vendas dhe të huaj? Cilët po investojnë më shumë?<br>3. Cilat janë investimet më të mëdha që kanë ndodhur gjatë vitit të fundit?<br>4. Sa projekte janë duke u zbatuar gjatë kësaj periudhe?<br>5. Sa projekte që po zhvillohen kanë marrë hapsira në plazhe? | 23.05.2024 | **1. Në cilat zona bregdetare janë duke u zhvilluar projekte në fushën e ndërtimit?**<br>Me qenë se dokumentari do të ketë fokus sektorin e turizmit, për projektet në fushën e ndërtimit i referoheni projekteve që po zhvillohen në sektorin e turizmit.<br>Nëse këto projekte i referohen këtij sektori, atëherë ju informojmë se interesat e paraqitura pranë AIDA për investime në turizëm prekin një pjesë të vijës bregdetare të vendit tonë dhe përfshijnë qytete si Lezhë, Durrës, Kavajë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë.<br>**2. Cili është raporti mes investitorëve vendas dhe të huaj? Cilët po investojnë më shumë?**<br>Nëse i referohemi aplikimeve për status investim/investitor strategjik në sektorin e turizmit, numri i aplikimeve nga subjektet shqiptare është disi më i lartë se ato të huaja. Megjithatë, duke marrë në konsideratë edhe promovimin/njohjen që vendi ynë ka marrë ndërkombëtarisht, vitet e fundit, shprehjet e interesit nga kompanitë e huaja janë rritur ndjeshëm.<br>Si ndërmjetës mes investitorëve dhe Qeverisë së Shqipërisë, AIDA siguron qasje në informacione të përditësuara, siguron një | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mënyrë efikase të komunikimit me organet qeveritare dhe shërben si një "One-Stop-Shop", duke mbështetur investitorët gjatë gjithë procesit të investimit.<br>Sjellim në vëmendjen tuaj se Shqipëria ofron një legjislacion shumë miqësor për investitorët e huaj, të cilët trajtohen me parimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes.<br>**3. Cilat janë investimet më të mëdha që kanë ndodhur gjatë vitit të fundit?**<br>Një projekt investimi i konsiderueshëm dhe i rëndësishëm është ai i "Marinës dhe Jahtet e Durrësit". Subjekti investues do të realizojë një projekt të integruar me port turistik dhe struktura akomoduese elitare, rezidenca me standard të lartë dhe shërbime në funksion të tyre. Projekti do të zhvillohet në zonën e Portit Durrës, ndarë në Faza zhvillimi nr. 1 dhe nr. 2.<br>**4. Sa projekte janë duke u zbatuar gjatë kësaj periudhe?**<br>Në kuadër të ligjit të investimeve strategjike nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kanë përfituar statusin investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë, rreth 26 projekte në sektorin e turizmit.<br>Sjellim në vëmendjen tuaj se projektet që kanë përfituar status strategjik, në asnjë rast nuk konsiderohen investime, qoftë sipas kuadrit ligjor vendas ashtu edhe atij | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Kjo për faktin se, për çdo projekt të miratuar miratohet në parim realizimi i projektit, materializimi i të cilit bazohet më pas në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.<br>**5. Sa projekte që po zhvillohen kanë marrë hapsira në plazhe?**<br>Referuar projekteve të cilat kanë përfituar statusin investim/investitor strategjik, vetëm 5 subjekteve iu është miratuar lejimi i përdorimit të brigjeve të detit me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike, miratim ky i cili është rregulluar më pas me aktet nënligjore përkatëse sipas legjislacionit sektorial në fuqi për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, përkundrejt tarifave përkatëse, të përcaktuara sipas vendimeve të Këshilleve Bashkiake. | | |
| **8.** | 24.05.2024 | Ne vijim te emailit tuaj ju sqarojme si me poshte vijon:<br><br>Sa statuse te investitorit strategjik ka revokuar AIDA? Ju lutem te na vini ne dispoziciont e dhenat e ketyre projekteve dhe arsyet se perse jane anuluar. | 29.05.2024 | Ne vijim te emailit tuaj ju sqarojme si me poshte vijon:<br><br>• A ka nje shprehje interesi prane AIDA-s per zhvillimin e nje resorti turistik ne Zvernec? Nese po, cila eshte kompania e interesuar dhe cfare parashikon me detaje kerkesa per shprehje interesi ?<br>Ju bejme me dije se prane AIDA nuk eshte paraqitur asnje shprehje interesi lidhur me zhvillimin e nje resorti turistik ne Zvernec. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Sa statuse te investitorit strategjik ka revokuar AIDA? Ju lutem te na vini ne dispoziciont e dhenat e ketyre projekteve dhe arsyet se perse jane anuluar.<br>Ne reference te nenit 19 te ligjit te Nr. 55/2015 “Per investimet strategjike ne RSH” i ndryshuar parashikohet se “Ne rast se pergjatë pergatitjeve, zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komiteti i Investimeve Strategjike konstaton dhe verteton se ne projektin investues ka te dhena te paverteta apo ndryshim te te dhënave te dala rishtazi, mbi bazen e te cilave nuk do te ishte vendosur per perfshirjen e ketij projekti ne proceduren e asistuar/e veçante, Komiteti i Investimeve Strategjike revokon vendimin per dhenien e statusit “Investim/investitor strategjik, procedure e asistuar/e veçante”. Deri me tani prane Sekretariatit Teknik te KIS, AIDA, nuk ka asnje rast te referuar ku autoriteti publik pergjegjes per monitorimin e nje projekti investimi te jete ndodhur perballe kushteve te parashikuara e vertetuara ne kete dispozite. | | |
| **9.** | 28.05.2024 | 1- Një kopje të planin të biznesit të propozuar nga subjekti investues , kompania [redacted], për të përfituar statusin “Investitor/investim strategjik procedurë e asistuar”, ose “Investitor/investim strategjik procedurë e | 30.05.2024 | Prane AIDA nuk eshte paraqitur asnje shprehje interesi per zonen e Zvernecit.<br>Nderkohe, per sa i takon projektit ne ishullin e Sazanit AIDA është duke vleresuar dokumentacionin dhe të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit”.<br>Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA ‘autorizimin mbi dakordësinë e | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | veçantë”, për projektin e zhvillimit turistik të zonës së Sazanit dhe Zvërnecit<br>2- Një kopje të planin e financimit të propozuar nga subjekti investues , kompania [redacted], për të përfituar statusin “Investitor/investim strategjik procedurë e asistuar”, ose “Investitor/investim strategjik procedurë e veçantë”, për projektin e zhvillimit turistik të zonës së Sazanit dhe Zvërnecit<br>3- Një kopje të dokumentit mbi vlerësimin e ndikimit social, ekonomik dhe strategjik të projektit të propozuar nga subjekti investues, kompania [redacted], për të përfituar statusin “Investitor/investim strategjik procedurë e asistuar”, ose “Investitor/investim strategjik procedurë e veçantë”, për | | investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’.<br>Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 ‘Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike’ ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se:‘Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar’.<br>Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | projektin e zhvillimit turistik të zonës së Sazanit dhe Zvërnecit<br>4-Një kopje të dokumentit mbi përfitimet ekonomike, sociale dhe operacionale si edhe niveli i punësimit që parashikohen të realizohen të propozuar nga subjekti investues , kompania [redacted] për të përfituar statusin “Investitor/investim strategjik procedurë e asistuar”, ose “Investitor/investim strategjik procedurë e veçantë”, për projektin e zhvillimit turistik të zonës së Sazanit dhe Zvërnecit.<br>5- Një kopje të dokumentit mbi listën me të gjitha masat, incentivat dhe shërbimet mbështetëse që subjekti investues kërkon nga shteti shqiptar për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | realizimin e projektit investues të propozuar nga subjekti investues , kompania [redacted], për të përfituar statusin “Investitor/investim strategjik procedurë e asistuar”, ose “Investitor/investim strategjik procedurë e veçantë”, për projektin e zhvillimit turistik të zonës së Sazanit dhe Zvërnecit<br>6- Një kopje të dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie të propozuar nga subjekti nvestues , kompania [redacted], për të përfituar statusin “Investitor/investim strategjik procedurë e asistuar”, ose “Investitor/investim strategjik procedurë e veçantë”, për projektin e zhvillimit turistik të zonës së Sazanit dhe Zvërnecit | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 7-Një kopje të dokumentit që subjekti, kompania [redacted], nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi, nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. | | | | |